

## NË EMËR TË POPULLIT

***GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Agim Ademi dhe Sabedin Mushica, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mejreme Tahiri, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. V, nga ... , për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 lidhur me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës<sup>1</sup> dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>2</sup> të cilin sipas autorizimit e mbrojnë avokatët Sh. P, nga ... dhe B.B, nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan, PP.nr.130/2006, të datës 05 dhjetor 2006, të cilën e përfaqësonte prokurori A.Sh, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datat 18 shkurt 2016; 24 mars 2016 dhe 3 maj 2016, më datën 4 maj 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datën 10 maj 2016, e përpilojë me shkrim këtë :***

**AKTGJYKIM**

<sup>1</sup> Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

<sup>2</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

*I akuzuari A.V, nga babai S.dhe nëna Sh..., e lindur A..., i lindur më..., në fshatin ..., Komuna e ..., tani me vendbanim në ..., rr.”... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, tregtar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë i dënuar edhe më parë për vepër tjetër penale,*

## **ËSHTË FAJTOR**

### **I.**

*Sepse me datën..., rreth orës ... minuta, në fshatin ..., Komuna ..., pas një grindje paraprake me të dëmtuarit N.V, Sh. V dhe S. V nga i njëjti fshat, lidhur me një kontest të pazgjidhur pronësor, me paramendim dhe me dashje ka tentuar që t'i privoj nga jeta të njëjtit, në atë mënyrë që i pajisur me revole të markës “...”, model ..., kalibri ... mm, fillimisht shtënë në drejtim të dëmtuarit N.V , duke e goditur me një predhë në regjionin e stomakut, në anën e majtë dhe në kofshën e djathtë e duke i shkaktuar shok hemorragjik dhe më pastaj me armën e larhtëpërmendur shtënë edhe në drejtim të dëmtuarve Sh. V dhe S.V, ashtu që të dëmtuarit Sh. V, i shkaktonte plagë hyrëse në regjionin e sipërm të barkut dhe plagë tejshkuese në regjionin e parakrahut të djathtë, në formë të thyerjes së kockave metakarpale, ndërsa, të dëmtuarit S. V, i shkaktonte plagë tejshkuese në regjionin e kofshës së majtë, si dhe në regjionin e bërrylit të dorës së majtë dhe plagë qarëse në kokë e që të tre të dëmtuarve u janë shkaktuar lëndime të rënda trupore nga të shtënat e armës së zjarrit derisa i harxhohet municioni e që edhe*

***më pastaj të dëmtuarit si rast urgjent dërgohen për në Spitalin Regjional në Gjilan, përkatësisht në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, ndërsa i akuzuari arrestohet,***

***me këtë ka kryer veprën penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 lidhur me nenin 20 të KPK.***

## ***II.***

***Sepse në kohën e pavërtetuar më parë, pa autorizim ka siguruar dhe mbajtur në pronësi armë të zjarhtë edhe atë një revole të markës "...", model ..., e të cilën edhe e ka përdorë në kohën dhe vendin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që edhe më pastaj arma e lartpërmendur i sekuestrohet nga ana e pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës, Njësiti i Hetimeve Rajonale në Gjilan,***

***me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.***

***Andaj, trupi gjykues në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 38, 54, 60, 64, 66 dhe 67 të KPK, si dhe nenit 391 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,<sup>3</sup> të akzuarit A. V, i shqipton :***

## ***DËNIM ME BURGIM***

---

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.26/2003, e datës 06.07.2003.

***Ashtu që të akuzuarit A. V , për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burgim prej 2 (dy) vjet e 10 (dhjetë) muaj, ndërsa për veprën penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.***

***Duke u bazuar në nenin 71 paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK, të akuzuarit A.V i shqiptohet dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 1 (një) muaj, të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.***

***Të akuzuarit A.V koha e kaluar në paraburgim prej datës ....e deri më datën...., do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet më 1 (një) ditë e dënimit me burgim.***

***Konfiskohet arma e zjarrit "...", modeli ..., kalibri ...mm.***

***Të dëmtuarit N..., Sh.... dhe S. V, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil***

***Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 150 € (njëqindpesëdhjetë Euro), në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në emër të kompensimit të shpenzimeve të ekspertit mjeko-ligjor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.***

**ARSYETIMI**

## **1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve**

**Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, më datën ..., ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit A. V, nga ..., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 9 lidhur me nenin 20 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK.**

**Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.172/2006, i datës, i akuzuari A.V, është shpallur fajtor për shkak të veprave penale të lartcekura, ndërsa, me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.nr...., të datës ..., është anuluar ky aktgjykim dhe çështja i është kthyer të njëjtës gjykatë në rigjykim.**

**Me aktgjykimin tjetër të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr...., i datës ..., i akuzuari A.V, përsëri është shpallur fajtor për shkak të veprave penale të lartcekura, mirëpo, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr...., i ..., e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr....., të datës... dhe lënda i është kthyer Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda në rigjykim.**

**Me aktgjykimin e fundit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr...., të ..., i akuzuari A. V, është shpallur për shkak të veprave penale të cekura më lart, por, prapë Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr...., të datës..., përsëri e ka anuluar këtë aktgjykim dhe lënda është kthyer në rigjykim.**

**Pas kësaj, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe publik, prokurori i shtetit Afrim Shefkiu, e ka bërë përmirësimin dhe rikualifikimin ligjor të veprave penale, me ç'rast të akuzuarin Adem Veseli, e ka akuzuar për shkak të veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në**

*tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 lidhur me nenin 20 të KPK dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.*

*Prokurori A.Sh, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë kësaj aktakuze, të plotësuar dhe ndryshuar, duke i propozuar trupit gjykues që të akuzuarin ta shpall fajtor për kryerjen e këtyre veprave penale dhe ta dënojë sipas ligjit.*

*Të dëmtuarit S.... dhe N. V, trupit gjykues ja kanë dorëzuar fjalën përfundimtare të cilin me shkrim e ka përgatitur përfaqësuesi i tyre, avokati T. G, nga ...., ku kanë deklaruar se mbetën në tërësi, pranë fjalës përfundimtare të cilën e kanë paraqitur në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor, të datës 21 prill 2015, ku e kishin përkrahur fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe kanë paraqitur kërkesë pasurore juridike.*

*I akuzuari A. V dhe mbrojtësit e tij, avokatët Sh. P dhe B. B, gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues, që i akuzuari të lirohet nga akuza.*

**2. Deklarimi i të akuzuarit lidhur me aktakuzën dhe vendimi i trupit gjykues për pranimin e fajësisë**

*Gjatë shqyrtimit gjyqësor, të datës ...., pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari A.V, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, ndërsa e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi.*

*Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës*

*penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi nga ana e të akuzuarit A. V, ngase ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, trupi gjykues ka konstatuar se i akuzuari A.V, kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij, avokatët Sh.P dhe B.B; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat nga neni 316, paragrafi 1 deri në 3 të KPPK.*

### *3. Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor*

*Meqë i akuzuari A. V, nuk e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova :*

- dëgjimin e të dëmtuarve në cilësi dëshmitarëve S. dhe N.V;*
- dëgjimin e dëshmitarëve Xh.V, J. V, U. U, M. V dhe M. V;*
- leximin e deklaratave të dëshmitares Sh... dhe të dëmtuarit Sh.V;*
- provat materiale siç janë : fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës; skica nga vendi i ngjarjes; mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor; raportet mjekësore dhe atë : fletë lëshimet nr.6513, 3799, 3748, 6564, 3700; raportet nr.16417, 16418, 1641; raporti mjekësor i Poliklinikës "..."; procesverbali i Këshillit të Pajtimit të fshatit ....aktvendimi i Gjykatës Komonale në...i, N.nr....; Raporti i punës, si dhe*
- marrjen në pyetje të akuzuarit Adem Veseli.*

#### *3.1. Deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve*

**3.1.1. Dëshmitari S. V, gjatë marrjes në pyetje në seancat e shqyrtimeve gjyqësore kishte deklaruar se ditën kritike kishte filluar punimet në renovimin e shtëpisë dhe rregullimin e oborrit të tij, ku gjatë këtyre punimeve të njëjtit i kishte ndihmuar edhe dhëndri i tij U. U. Derisa ishte duke punuar në oborrin e tij, tek ai kishin shkuar edhe dy vëllezërit e tij N....dhe Sh.... Meqë në oborrin e tij duhet të kryheshin disa punë me traktor, ishte ftuar edhe një i afërmi i tyre J.V i cili e kishte marrë dhe e kishte drejtuar traktorin e tij. Në orët e pasdites në oborrin e tij kishte shkuar edhe i akuzuari A. V së bashku me vëllain e tij M. V, me ç'rast i akuzuari A.... e kishte thirr të dëmtuarin - dëshmitarin për të biseduar lidhur me mezhdën e pronave të tyre. Meqë me të njëjtin nuk kanë mundur të mirren vesh rreth kësaj, i njëjti iu ka thënë punëtorëve që të vazhdojnë punën, ku në ato çaste ka filluar që të tensionohet situata, me ç'rast i akuzuari A.... i revoltuar nga kjo iu ka drejtuar me fjalët "se këtu nuk mund të punoni, kjo do të mbetet shkret", por megjithatë ky nuk ia ka vënë veshin fjalëve të tij dhe e ka kthyer kokën me qëllim që të vazhdoj punimet, ku për një çast e kishte parë vëllain e tij Sh.... dhe e kishte dëgjuar duke i thënë të akuzuarit A.... "Mos e nxjerr atë revole se nuk është vendi për të", e që në ato çaste vetëm se i kishte dëgjuar të shtënat e revoles. Së pari me revole është goditur vëllai i tij N...., i dyti me radhë Sh...., ndërsa, dëshmitari S. V nuk e dinte se a është plagosur para Sh.... apo N...., por, i njëjti ka deklaruar se është goditur me revole me dy predha në pjesën e majtë të krahut dhe në këmbën e majtë. Herën e parë kur ka kërshur revolja i njëjti i ka kapur vëllezërit e tij N..... dhe Sh....duke u gërmucur në gjunjë në tokë. Pas kësaj, meqenëse revolja nuk i ka shkrepur më, dëshmitari S. V ka dashur që t'ia marrë revolën të akuzuarit A..., por nuk kishte arritur, ngase ishte i plagosur në krahun e majtë, ndërsa vëllau i tij Sh... e kishte goditur me lopatë të akuzuarin A... I akuzuari A... është goditur nga ana e Sh..., pasi që i akuzuari A... veç e kishte gjuajtur me armë. Pas kësaj, i akuzuari A...është tërhequr në drejtim të shtëpisë së tij dhe ka kërkuar një pushkë. Kanë dalur në oborrin e xhaxhait të tij dhe e kishte dëgjuar Sh... kur kishte**



*bërtitur “S... vëlla të vrau”, por dëshmitari kishte ecur, e më pastaj e kishte parë se dhe vëllau i tij Sh... ishte i lënduar në stomak dhe në dorë. Fillimisht e kishin dëguar në spital N..., pastaj Sh... dhe dëshmitarin S. V.*

*3.1.2. Dëshmitari Sh.V, 4 gjatë marrjes në pyetje në seancat e shqyrtimeve gjyqësore kishte deklaruar se ditën kritike përkatësisht më datën ..., kishte shkuar te vëllai i tij S. V për të shikuar se çfarë po bënte. Deri sa ishte në oborr ku po kryheshin punët kanë ardhur fillimisht i akuzuari A..., ndërsa pas tij edhe M.V. I akuzuari A... e kishte thirrë vëllain e tij S... që të bisedojnë lidhur me mezhdën, ku të njëjtit i ka thënë se e ke lëvizur mezhdën dhe e ke asgjësuar gurin e mezhdës. Në oborr prezent kishin qenë punëtorët që ishin duke punuar, dhëndri i tyre U.U, J.V, Xh.V dhe N. V, ku i akuzuari A... u ka thënë atyre që mos të punojnë. Kështu që deri sa ata ishin duke punuar në oborr kishte vërejtur se i akuzuari A...ka nxjerrë nga brezi revolen, e që në veprimet e tij ka reaguuar me fjalët “mos e nxjerr revolen se nuk është për me e nxjerrë në mes të vllaznillakut”, me atë rast vëllai i tij S... ia ka mbyllur gojën me dorë, ku në ato çaste i akuzuari A..., fillimisht ka shtënë me një predhë në N... duke e goditur në stomak, e përderisa dëshmitari Sh.V e ka mbajtur vëllain e tij S..., i akuzuari ka shtënë në dëshmitarin dhe në vëllain e tij S..., ku me këtë rast dëshmitarin Sh. V e ka goditur me një predhë në stomak, ndërsa me predhën tjetër në dorën e djathtë, ndërsa vëllain e tij S... e ka goditur në krahun e majtë dhe në këmbën e majtë. Në ato çaste pasi i akuzuari A... e ka harxhuar municionin, Sejdiu është vërsulur në drejtim të tij për t’ia kapur revolen nga dora pasi që vëllai i tij Sejda ka arritur të ja kapë revolen të akuzuarit Adem nga dora, i njëjti ka ikur dhe ka shkuar në shtëpi, ndërsa dëshmitari Shaip, bashkëshortja dhe dhëndri i tij fillimisht e kanë dërguar në ambulancën e Vitisë, ku për shkak të plagosjes serioze është përcjelle në Spitalin e Gjilanit, e më pas në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë me ç’rast*

---

<sup>4</sup> Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 368 paragrafi 1 të KPPK, gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 18 shkurt 2016, kishte marrë aktvendim që të lexohen deklaratat e të ndjerit Shaip Veseli.

**është bërë intervenimi kirurgjik dhe i është hequr predha nga stomaku.**

**Dëshmitari gjithashtu ka shtuar se të akuzuarin ....e ka goditur me lopatë më vonë pasi që i njëjti veç se i kishte sulmuar me armë të dëmtuarit.**

**3.1.3. Dëshmitari N. V, gjatë marrjes në pyetje gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se ditën kritike pasi që ishte kthyer nga puna, kishte shkuar në oborrin e vëllait të tij për të shikuar se çka është duke punuar. Vëllai i tij S. V kishte kërkuar nga ai që t'ia sigurojë një traktor me pajisje shtesë me qëllim që ta rrafshojë dheun në oborrin e tij, ku i afërmi i tyre A.A ia kishte dhënë traktorin me të cilin punonte kushëriri i tij J.V. Derisa ishin duke punuar në oborr kishte ardhur i akuzuari A..., i cili e kishte thirrur vëllain e tij S....për të biseduar lidhur me sinorët dhe gjatë bisedës rreth sinorëve i akuzuari A.... i ka thënë vëllait të tij S..., se me qëllim e ke mënjanuar gurin dhe e ke asgjësuar mezhdën, ku në bisedën e tyre është involvuar edhe vëllai i të akuzuarit M..., duke tentuar që të mos vijë deri te konflikti, pasi që ai me axhën e tij e kishin vënë gurin dhe e dinë se ku është sinori. Vëllai i tij S.... ka propozuar që të ftohen personat e autorizuar që ta kthejnë sinorin në mes të ngastrave të tyre, ku më pastaj i njëjti i ka propozuar punëtorëve që ta vazhdojnë punën dhe nesër do të vijnë gjeodetët dhe do të rregullohet kjo çështje. Me atë rast i akuzuari A.... ka reaguuar me fjalët “qe valla nuk keni me punu këtu”, ku me këtë rast Sh.... e ka parë se i akuzuari A.... e ka nxjerr revolen dhe i ka thënë se mos e nxjerr atë revole se nuk është duke tu dashur. Megjithatë i akuzuari A... nuk ka pritë dhe ka shtënë me revole fillimisht në drejtim të dëshmitarit N..., ku me një predhë e ka goditur në stomak e që edhe është rrëzuar për tokë dhe pastaj kishte dëgjuar edhe disa të shtëna tjera dhe atë pa ndërprerje, por, meqenëse ishte i plagosur e kishte humbur kontrollin dhe nuk e dinte se çka kishte ndodhur pastaj. Të njëjtit vetëdija i është kthyer në spital dhe atëherë kishte kuptuar se nga ana e të**

*akuzuarit A... janë plagosur edhe vëllezërit e tij Sh... dhe S... Ka theksuar se ngjarja ka ndodhur në oborrin e vëllait të tij S.V, ku prezent ishin edhe J. V i cili e drejtonte traktorin, Xh. V dhe dhëndëri i tij U. U. Përveç të akuzuarit A... në vendin e ngjarjes kishin qenë edhe vëllai i tij M... e më pastaj kishte ardhur edhe nëna e tij Sh..., më pastaj ka deklaruar se dëshmitari është trajtuar prej datës ....e deri më datën ..., por se gjendjen shëndetësore kishte të rëndë edhe më tej. I njëjti ka shtuar se predha nuk i është larguar nga trupi deri para vitit të ri ..., kur i është nënshtruar një operacioni në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë.*

### **3.2. Deklaratat e dëshmitarëve**

*3.2.1. Dëshmitari Xh.V gjatë marjes në pyetje gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se ditën kritike kishte shkuar te kusherinjtë e tij S,Sh dhe N..., përderisa të njëjtit punonin në rregullimin e oborrit e që me ta ishte duke punuar edhe vëllau i tij i cili punonte me traktor. Në vendin e ngjarjes i kujtohet se ka ardhur i akuzuari A... edhe pas tij menjëherë, ka ardhur edhe M... me një fëmijë për dore. I akuzuari A... fillimisht e kishte ftuar S... për ta shiqur gurin e mexhës se ku gjendet, me atë rast ka filluar biseda rreth kufirit, ku edhe kanë lindur mosmarveshjet në mes tyre. Më pastaj kishte zbritur te shtëpia e S..., pra në oborrin e shtëpisë së tij, ku A... i kishte thënë S...se a po e sheh se edhe gypat e kanalizimit i kishte vendosur në pjesën e oborrit të shtëpisë të tij. Derisa të njëjtit fjloreshin rreth kufirit, Sejdiu i kishte thënë të akuzuarit Ademit se kjo çështje mund të rregullohet përmes punëtorëve te gjeodezisë, megjithatë i akuzuari Adem refuzonte këtë dhe Sejdiu i ka vazhduar punimet. Dëshmitari ka vërejtur se situata është tensionuar, ku Ademi e ka vu dorën në brez dhe e kishte nxjerr edhe revolen, ku në ato çaste Shaipi i kishte thënë Ademit “ Qit të pshursha në të”, ku Ademi më pastaj ka shtënë në drejtim të Nexhmedinit e më pastaj në*

*drejtim të Sh...e S... pa ndërprerë derisa sa e ka harxhuar municionin. I është kujtuar se në ato çaste edhe pse i qëlluar, Sh... e kishte goditur me lopatë në kokë të akuzuarin A... . Pas kësaj dëshmitari ishte angazhuar edhe me vëllaun e tij J.... që t'ju ofrojnë ndihmën të plagosurve. Dëshmitari Xh. V gjithashtu edhe njëherë kishte ritheksuar se i pari ditën kritike është plagosur N..., i dyti Sh... dhe në fund është plagosur S.... Kjo do të thotë se paraprakisht N..., pastaj S...vet kanë qenë të plagosur me armë zjarri nga i akuzuari A..., si dhe Sh...pasi që është plagosur e ka goditur me lopatë të akuzuarin A....*

*3.2.2. Dëshmitari J. V , gjatë marrjes në pyetje gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë duke punuar me traktor në oborrin e S.V . Derisa kishte qenë duke punuar aty kah ora ...në oborrin e S.... kishte ardhë i akuzuari A. V , pastaj edhe vëllai i tij M.V . Kishte vërejtur se i akuzuari A.... dhe S....po grindeshin lidhur me sinorin me ç'rast e kishte ndal traktorin për të parë se çka po ndodh. I akuzuari A... e kishte ftuar S....që të sqarohet se ku është sinori duke i thënë S.... se e ke lëvizur gurin e sinorit, mirëpo meqenëse nuk erdhi deri te marrëveshja në këtë drejtim, S....u kishte thënë punëtorëve që të vazhdojnë punën, ndërsa i akuzuari A.... kishte reaguar me fjalët duke thënë “nuk do të punoni këtu do të mbetet shkret” e që edhe për njëherë kishte nxjerrë revolen dhe kishte shtënë në drejtim të N.... , e që pastaj kishte vazhduar me të shtënë e pandërprera derisa kishte municion. Kishte vërejtur se edhe S... dhe Sh... po ashtu kishin qenë të plagosur dhe se Sh... në gjendje të plagosur e kishte goditur të akuzuarin A... në kokë.*

*Dëshmitari J. V gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, përveç tjerash ka shtuar se që nga momenti kur ka ndodhur rasti, i akuzuari A... kishte kërkuar nga ai që ta shtrembëroj deklaratën, mirëpo, i njëjti i kishte thënë se unë do të jap deklaratë të njëjtë, ngase të dyve ju kam djem të axhës.*

**3.2.3. Dëshmitari U. U, gjatë marrjes në pyetje gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë duke punuar te miku i tij S. V në një kanal dhe në rrafshimin e oborrit. Derisa kishte qenë duke punuar në oborr kishte ardhur i akuzuari A.V i cili kishte reaguar se pse po punojnë në oborr ku me atë rast kishte reaguar edhe miku i tij S..., duke thënë se punimet po i bëjnë në oborrin e tij dhe se këtë çështje mund ta zgjidhin në mënyrë të qetë, mirëpo kishte ardhur deri te mosmarrëveshja me ç'rast i akuzuari A... kishte nxjerr revolen dhe kishte shtënë në drejtim të N... e më pastaj edhe në drejtim të Sh.... dhe S.... Gjithashtu, ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ka qenë edhe nëna e të akuzuarit A.... dhe se i akuzuari A... ka shkrepur shtatë predha nga revolja dhe se predhën e parë e kishte shkrepur në drejtim të garazhës dhe se kjo ishte bërë me qëllim që ta provoj.**

**3.2.4. Dëshmitarja Sh. V, gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit në Prokurorinë Publike të Qarkut në Gjiilan, me datën ....kishte deklaruar se djali i saj i akuzuari A...pasi që kishte ardhur nga...kishte vërejtur të dëmtuarit Sh... dhe N....së bashku me U. U se po e mbulonin kanalën me ujë, i cili kalon nëpër pasurinë e të akuzuarit A... I akuzuari A... i është drejtuar për të biseduar lidhur me atë kanal, kurse, pas tij ka ardhur edhe M... Ajo ka parë se i akuzuari A... dhe S...po bisedonin dhe situata në mes tyre kishte filluar që të tensionohej e që Sh. V e ka sharë të akuzuarin Adem dhe është vërsulur ndaj të njëjtit, si dhe të tjerët pastaj janë vërsulur dhe dikush me lopatë e ka goditur në kokë të akuzuarin Adem, por që nuk e ka parë se kush e ka bërë këtë, pasi ishte tollovi. Pas kësaj, pasi që i akuzuari Adem ishte përgjakur kishte nxjerrë revolen dhe njëherë kishte shtënë në ajër, e pastaj 2-3 herë në drejtim të dëmtuarve dhe fatkeqësisht ndodhi ajo që të dëmtuarit kanë pësuar lëndime, po ashtu edhe djali i saj i akuzuari Ademi.**

**3.2.5. Dëshmitarja M. V , gjatë marrjes në pyetje gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore kishte deklaruar se ditën kritike pasi që burri i saj-i akuzuari A... ishte kthyer nga puna në shtëpi ka shkuar për të biseduar me kushëririn e tij S.... dhe vëllezërit e tij lidhur me mbulimin e kanalit te ujit. Në oborr ishte edhe vjehrra e saj Sh.V e që më vonë kishte shkuar edhe kunati i saj M. V . Pasi kanali i ujit kalon nëpër oborrin e tyre, i akuzuari A.... ia kishte tërhequr vërejtjen S....që mos ta mbulonin kanalin, ngase, ujërat e shirave ja vërshojnë oborrin, por S.... nuk ka dashur të dëgjojë për t'i ndërprerë punimet me pretendimin se kanali është i tyre. Dëshmitarja ishte në një distancë prej 5-6 metrave dhe e kishte parë ngjarjen kur situata tensionohej dhe kur ishte sulmuar bashkëshorti i saj - i akuzuari A..., bile dikush nga ata e kishin goditur me lopatë mbi kokë e që paraprakisht ja kanë sharë edhe nënën, ku për një moment bashkëshortin e saj e kishte mbuluar gjaku. Në ato qaste bashkëshorti i saj A.... kishte nxjerrë revolen nga brezi dhe kishte shtënë njëherë në ajër për të zbrapsur, meqë vazhdimisht ata e sulmonin me lopata. Dëshmitarja i kishte marrë fëmijët dhe i kishte futur në shtëpi për t'i qetësuar e që edhe në ato qaste kishte dëgjuar disa të shtëna nga arma e zjarrit. Me të dalur nga shtëpia e kishte parë të akuzuarin A.... të plagosur në kokë e të cilin e ndihmonte M.....duke e mbajtur në kraharor, më pastaj kishte kuptuar se Sh..., N..... e S....ishin plagosur nga ana e zjarrit me të cilin kishte shtënë bashkëshorti i saj A... .**

**3.2.6. Dëshmitari M. V, gjatë marrjes në pyetje gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike ka qenë dita e parë e muajit të “Ramazanit” dhe vëllai i tij, i akuzuari A.V, pasi që ishte kthyer nga puna, ka shkuar në shtëpi. Gjithashtu, edhe dëshmitari M. V ka shkuar te shtëpia e të akuzuarit për ta vizituar nënën e tij, ku pasi që ka parkuar veturën kishte parë se të dëmtuarit kishin qenë duke punuar rreth një kanali në mes të shtëpisë së akuzuarit dhe të dëmtuarit S.... Dëshmitari e ka marrë djalin e të akuzuarit A... i cili ishte tre vjeçar dhe ka shkuar që të**

*bisedoj me të dëmtuarit lidhur me këtë kanal duke kërkuar nga të dëmtuarit që mos të mbyllet ky kanal. Derisa ishte duke biseduar me të dëmtuarin S..., në një vend pak më poshtë afër shtëpisë së re kanë filluar sharjet ndaj A...nga ana e N..., Sh....dhe U... Duke e parë se po ndodh një incident është interesuar për ta larguar djalin e vogël, ndërsa atje veç ka filluar përleshja dhe të akuzuarin A.... e kanë goditur me lopatë, mirëpo nuk e di se kush. Në ato momente i akuzuari ka qenë i përgjakur dhe është tërhequr mbrapa me qëllim që të shpëtoj për arsye se ata prapë ju kanë vërsulur, ngase kanë qenë katër persona me lopata dhe në ato momente i akuzuari e ka nxjerr revolen dhe ju ka thënë “mos mu ofroni edhe një herë se ju vras “. Para se ta thotë thoshte këtë fjalë, i njëjti ka shtënë në ajër me armë, ku ata edhe pas kësaj ju kanë vërsulur të akuzuarit, me ç’rast i njëjti për me shpëtuar vetveten e ka përdorë armën edhe atë jo me qëllim t’i vras, ngase edhe ashtu kanë qenë shumë afër mes veti. Përveç asaj të shtënës në ajër, i akuzuari A... ka shtënë me armë edhe në drejtim të dëmtuarve dhe atë kanë qenë dy të shtëna tjera.*

### **3.3. Provat materiale**

*Nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.F. D, shihet se të dëmtuarit S. V, N. V dhe Sh. V kanë pësuar dëmtime të rënda trupore, ndërsa i akuzuari Adem Veseli ka pësuar dëmtime të lehta trupore. Sipas mendimit të lartcekur të ekspertit mjeko-ligjor,*

*i dëmtuari Sejdi Veseli, ka pësuar plagë tejshkuese nga arma e zjarrit në regjionin e bërrylit të dorës së majtë dhe plagë tagjenciale (shkarazi drejtë) e shkaktuar nga arma e zjarrit në regjionin e kofshës së majt, plagë çarëse-shqyerse të indeve të buta në regjionin moror të anës së djathtë të kohës, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së*

**hedhur nga arma e zjarrit dhe veprimi mekanik të mjetit të fort mbretës;**

**i dëmtuari Sh.V, ka pësuar plagë hyrëse e cila është shkaktuar nga arma e zjarrit në regjionin e sipërm të barkut dhe plagë tejshkuese në regjionin e parakrahur të dorës së djathtë, thyerje të kockave metakarpale (kockave të rrënjëve të gishtërinjëve) të shuplakës së dorës së djathtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga amra e zjarrit;**

**i dëmtuari N. V , ka pësuar plagë hyrëse të shkaktuar nga arma e zjarrit në regjionin e barkut (nën dhe majtas kërthizës), shok hemorragjik (gjendje akute e rëndë për shkak të gjakderdhjes) dhe gërvishtje lëkurore në vidhën (mollaqën) e kofshës së këmbës së djathtë, me besueshmëri të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe veprimi mekanik, i mjetit të fortë mbretës, kurse,**

**i akuzuari A.V , ka pësuar plagë të cilat paraqesin ndrydhje (mbretje) me plagë çarëse-shqyrse të indeve të buta në regjionin muror të anës së majtë të kokës dhe gërvishtje lëkurore në laprën e vesht të majtë, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur).**

**Nga raportet mjekësore dhe atë : fletë lëshimet nr....., ....., ....., ....., .....; raportet nr.....,....., ....; raporti mjekësor i Poliklinikës “...”; shihet se të dëmtuarit S.V dhe Sh. V, si dhe i akuzuari A. V i janë nënshtruar terapisë mjekësore për shkak lëndimeve trupore.**

**Nga procesverbali i Këshillit të Pajtimit të fshatit..., Komuna e.... i datës ....shihet se familjet e të dëmtuarve dhe të akuzuarit janë pajtuar në mes vete.**

**Përmes fotografive të bëra në vendin e ngjarjes shihet vendi i ngjarjes dhe hapësira për rreth tij, ndërsa, nga aktvendimi i Gjykatës Komunale në ...., N.nr ....i datës...., shihet se është rregulluar kufiri në mes te ngastrës kadastrale nr.... dhe nr..... inicuar sipas propozimit të propozuesit S. V andaj**



***kundërpropozusve S. D dhe M. V, rregullim i kufirit ky që mund të shihet nga raporti i punës të ekspertëve gjoedet.***

***Nga skica dhe foto dokumentacioni i bërë nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës shihet se ditën kritike me rastin e punimeve në rrafshimin e oborrit dhe mbulimin e kanalit në mes të oborrit të akuzuarit A.V dhe të dëmtuarit S. V, ka ardhur deri te zënka në atë mënyrë që i akuzuari A. V ka shtënë së pari në drejtim të dëmtuarit N. V e pastaj në të dëmtuarit Sh....dhe S.V.***

### ***3.4. Deklarimi i të akuzuarit A.V***

***I akuzuari A.V, gjatë marrjes në pyetje gjatës seancave të shqyrtimeve gjyqësor siç është cekur edhe më lart nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, ndërsa, e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi. I njëjti gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësor ka deklaruar se e ka patur armën me vete dhe pasi që ka shtënë në ajër si shenjë paralajmëruese, armën e ka përdorur në vetëmbrojtje. Me këtë armë ka shtënë në drejtim të dëmtuarve, ngase, të njëjtit kanë qenë katër persona me lopata dhe të njëjtin kanë qenë në sulm. Nuk e ka ditur se sa herë ka shtënë në drejtim të dëmtuarve dhe sa municion ka patur revolja. Ka deklaruar se sa i përket lëndimeve që ka pësuar, nuk bëhet fjalë për një goditje, por i njëjti ka pësuar disa goditje. Nuk i është kujtuar, se cilin nga të dëmtuarit e ka goditur të parin dhe renditja e goditjeve. Në fund, ka shtuar se të dëmtuarit kanë dashur që ta largojnë nga shtëpia, në atë mënyrë që duke ja mbyllur kanalën, uji do t'i hyjë në oborr dhe shtëpi.***

### ***4. Analizimi dhe vlerësimi i provave***

*Trupi gjykues i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk duhet t'i falet besimi deklarimit të të akuzuarit A. V, të dhënë gjatë seancave shqyrtimeve gjyqësore me të cilin e mohon kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi dhe se kjo sipas vlerësimit të trupit gjykues është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Trupi gjykues nuk ja fali besimin deklarimit të të akuzuarit A. V, për shkak se një deklaram i tij është në kundërshtim me provat të cilave trupi gjykues ja ka falur besimin, siç janë deklaratat e dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve: S..., Sh... dhe N.V, në njërin anë, si dhe deklaratave të dëshmitarëve Xh.V, J.V dhe U. U, në anën tjetër.*

*I akuzuari A.V, nuk e ka mohuar faktin se ditën kritike, pas një mosmarrëveshje që kishte, me armën e tij të zjarrit ka shtënë në drejtim të të dëmtuarve S..., Sh.... dhe N.... V..., mirëpo, i njejt i ka deklaruar se këtë e ka bërë nën kushtet e mbrojtjes së nevojshme, me arsyetimin se kinse paraprakisht ka qenë i sulmuar me lopata nga ana e të dëmtuarve. Një pretendim i tillë i të akuzuarit A. V, është në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarve S..., Sh.... dhe N. V, të cilat gjatë të gjitha fazave të procedurës penale në mënyrë të qartë kishin deklaruar se “sulmin me armë në drejtim të tyre”, i pari e kishte filluar i akuzuari A.V, i cili kishte shtënë në drejtim tyre. Ndërsa, të dëmtuarit S.... dhe Sh.V, përveç kësja, edhe kanë deklaruar se pasi që janë sulmuar me armë të zjarrit nga ana e të akuzuarit A.V, i dëmtuari Sh.V, edhe pse ishte i plagosur, ka arritur që një herë me lopatë ta godasë të akuzuarin A. V. Një pretendim i tillë i të dëmtuarve, sipas vlerësimit të trupit gjykues, është i besueshëm dhe bindës, për shkak se është në harmoni me njëri-tjetërin dhe është në harmoni edhe me deklaratat e dëshmitarëve Xh.V, J. V dhe U.U. Edhe dëshmitarët Xh... dhe J.V, të cilin kanë qenë dëshmitarë okular në vendin e ngjarjes, kanë deklaruar se “sulmin i pari e ka filluar i akuzuari A.V”, cili ka shtënë me*

*armën e zjarrit disa herë në drejtim të të dëmtuarve dhe se i dëmtuari Sh..., pasi që ishte i plagosur, ka arritur që me lopatë një herë ta godas të akuzuarin A. V. Trupi gjykues i ka vlerësuar shumë lart deklaratat e dëshmitarëve Xh.... dhe J.V, si dhe të njejtëve ja ka faluar besimin e plotë, për shkak se deklaratat e tyre janë tejet bindëse, objektive dhe në harmoni njëra me tjetrën dhe me deklaratat e të dëmtuarve. Përveç këtyre arsyeve, trupi gjykues, ia ka fali besimin e plotë këtyre dy dëshmitarëve, edhe për dy arsye: sa pari, se të njejtit në mënyrë të njejtë kanë deklaruar, edhe gjatë marrjes në pyetje më parë gjatë procedurës penale dhe së dyti, për shkak të raporteve të tyre me të dëmtuarit dhe me të akuzuarin. Dëshmitarët Xh....dhe J. V , janë në raporte të njejtë familjare, si me të dëmtuarit, ashtu edhe të akuzuarit, ngase, të dëmtuarit dhe të akuzuarin i kanë djemë të axhallarëve. Kjo bënë që deklaratat e tyre, nga ana e trupit gjykues të vlerësohen si deklarata objektive dhe të paanshme. Edhe dëshmitari U. U, në përgjithësi, ka deklaruar në mënyrë të njejtë si dëshmitarët Xh. dhe J. V. Duke u bazuar të gjitha këto dhe në provat materiale të cekura më lart, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se ditën kritike, sulmin i pari e ka filluar i akuzuari A.V, i cili me armën e tij të zjarrit ka shtënë në drejtim të të dëmtuarve, duke tentuar që të njejtit t'i provojë nga jeta. Andaj, edhe pretendimi i të akuzuarit A. V, se ka vepruar nën kushtet e mbrojtjes së nevojshme është i pabazuar në ligj, për shkak se sipas nenit 8 paragrafi 2 të KPK “për tu konsideruar se personi ka vepruar nën kushtet e mbrojtjes së nevojshme, duhet që personi ta zbraps sulmin...” e që në këtë çështje penale u konstatua se sulmin e ka filluar vetë i akuzuari.*

*Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve Shahe, Makfire dhe Mustaf Veseli, trupi gjykues konstaton se përmes deklaratave të tyre është vërtetuar fakti se i pakontestueshëm se ditën kritike i akuzuari Adem Veseli ka shtënë me armë në drejtim të dëmtuarit. Në këtë pjesë trupi gjykues ja fali besimin këtyre dëshmitarëve, mirëpo se kush e ka filluar sulmin i pari, trupi gjykues nuk ja fali besimin këtyre dëshmitarëve, për shkak se dëshmitë e tyre në këtë drejtim janë në kundërshtim me*

*dëshmitë e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve të lartcekur, të të cilëve trupi gjykues ja ka falur besimin e plotë. Trupi gjykues deklaratat e këtyre tre dëshmitarëve, sa i përket faktit se kush e filluar sulmin i pari, i ka vlerësuar si deklaratat joobjektive, edhe për shkak të faktit se të njejtat janë në raporte të ngushta familjare me të akuzuarin (nënë, bashkëshorte dhe vëlla i të akuzuarit).*

## **5. Gjendja faktike e vërtetuar**

*Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :*

*- se i akuzuari A.V, me dashje e ka kryer veprën penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 lidhur me nenin 20 të KPK dhe me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

## **6. Elementet e veprave penale**

*Sipas nenit 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 të KPK, veprën penale të vrasjes së rëndë, e kryen “kushdo që me dashje kryen dy ose më shumë vrasje, përveç veprave penale të cilat janë paraparë në nenet 148 dhe 150 të KPK<sup>5</sup>”. Pra, veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në privimin me dashje nga jeta të dy ose më shumë personave dhe për këtë formë të*

---

<sup>5</sup> Në nenin 148 të KPK, është parashikuar vepra penale vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor, kurse në nenin 150 të KPK, është parashikuar vepra penale e vrasjes së foshnjeve gjatë lindjes.

***kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë. Në nenin 20 paragrafët 1 dhe 3 të KPK, është parashikuar se “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK”.<sup>6</sup> Kurse, në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenet 17 deri 21 të Ligjit për Armët,<sup>7</sup> është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.***

## ***7. Vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit***

***Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykses e shpalli fajtor të akuzuarin Adem Veseli, për shkak të kryerjes së veprës penale vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 11 lidhur me nenin 20 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë elementet e këtyre veprave penale dhe se për të njejtat është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i akuzuari Adem Veseli, siç është***

---

<sup>6</sup> Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK, “Dënimi i shqiptuar për tentativë nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale”.

<sup>7</sup> Ligji nr.03/L-143 për Armët, i datës 17.09.2009.

*cekur edhe më lart, me dashje ka tentuar që t'i privojë nga jeta dy ose më shumë persona (të dëmtuarit Shaip, Sejdi dhe Nexhmedin Veseli) me armën e zjarrit të cilin e ka mbajtur në posedim paautorizim dhe leje valide.*

## **8. Vendimi lidhur me rikonstruimin e vendit të ngjarjes**

*Duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të paraqitura në aktvendimin PAKR.nr.905/2012, të datës 24 qershor 2013, që “sipas nevojës të bëhet edhe rikonstruimi i vendit të ngjarjes”, kryetari i trupit gjykues, së bashku me anëtarin e parë të trupit gjykues të mëparshëm, më datën 23 dhjetor 2014, kanë dalur në vendin e ngjarjes ku kanë bërë shiqimin dhe fotografimin e drejtpërdrejt të vendit të ngjarjes. Pas kësaj, është konstatuar se nuk ka mundësi objektive që të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes, përkatësisht do shkaktohej një dëm i madh nëse bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes, ngase, nga koha kur është kryer vepra penale ka kaluar një kohë e gjatë, kurse, rrethanat në vendin e ngjarjes kanë ndryshuar, për shkak se te vendi i ngjarjes është ndërtuar një muri me blloka dhe material të fortë; shtëpia e vjetër është prishur dhe në vend të saj është ndërtuar një shtëpi e re; se te vendi ku është kryer vepra penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi janë mbledhur pemë të cilat janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, gjë që mund të shihen edhe nga fotografitë e vendit të ngjarjes të cilat gjenden në shkresa të lëndës.*

## **9. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve**

*Me rastin e matjes së dënimeve ndaj të akuzuarit A. V, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 64, 66 dhe 67 të KPK. Në këtë aspekt, si rrethana posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin, trupi gjykues e ka marrë për bazë faktin se vepra penale e vrasjes së rëndë ka mbetur në tentativë. Fakti se vepra penale e vrasjes së rëndë ka mbetur në tentativë, është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur edhe me rrethanat e shënuara mëposhtë dhe duke u bazuar në nenin 20 paragrafi 3 të KPK, janë rrethana që e arsyetojnë zbutjen e dënimit, sipas neneve 66 dhe 67 të KPK. Në nenin 20 paragrafi 3 të KPK, është parashikuar se “personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet më butë se sa kryerësi”, që do të thotë, sipas kësaj dispozite ligjore, tentativa konsiderohet rrethanë obligative mbi bazën e së cilës, gjykata, duhet që ta dënojë kryerësin më butë, përkatësisht, ta zbutë dënimin. Mirëpo, kur është fjala për kufijtë e zbutjes së dënimit për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 të KPK, ligjdhënësi me rastin e hartimit të dispozitave ligjore nuk ka qenë shumë i qartë, përkatësisht dispozitat ligjore në këtë aspekt janë konfuzë. Kjo për faktin se në nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPK, është parashikuar se “Nëse për veprën penale është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, dënimi mund të zbutet deri në dhjetë vjet burgim”. Mirëpo, për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 i KPK, është parashikuar dënimi me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë. Kështu, që nuk do të ishte e logjishme që për këtë veprë penale, gjykata, të ketë mundësi për ta zbutur dënimin vetëm deri në dhjetë vjet burgim, ngase, edhe ashtu, edhe pa i zbatuar fare dispozitat ligjore të zbutjes së dënimit, gjykata do ta ketë këtë mundësi, që kryerësin ta dënojë me të paktën dhjetë vjet burgim. Si rezultat i kësaj, trupi gjykues me rastin e zbutjes së dënimit për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, e ka aplikuar nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK, si dispozitë ligjore më e favorshme për të akuzuarin.*

*Përveç faktit që vepra penale e vrasjes së rëndë ka mbetur në tentativë, me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit*

*A.V, trupi gjykues i ka marrë për bazë edhe sjelljet e tij të mira gjatë seancave gjyqësore; se gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës...., pavarësisht faktit që nuk e ka pranuar fajësinë për shkak të kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, i njëjti kishte shprehur keqardhje për rastin që kishte ndodhur; faktin se sipas deklaratës së të akuzuarit, i njëjti është i martuar dhe është babë i dy fëmijëve, si dhe faktin se edhe vetë ka pësuar lëndime të lehta trupore. Ndërsa, trupi gjykues, si rrethanë rënduese për të akuzuarin e ka marrë për bazë faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër tjetër penale. Kështu, i akuzuari A. V , me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr..../.... të dates..., ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK. Gjithashtu, si rrethanë rënduese, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se të dëmtuarit S...., N....dhe Sh.V , kanë pësuar lëndime të rënda trupore.*

**10. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

*Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi unik me burgim i shqiptuar ndaj të akuzuarit A. V, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Trupi gjykues, vlerëson se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK, i cili konsiston në parandalimin e akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.*

**11. Vendimi lidhur me paraburgimin**



*Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 73 paragrafët dhe 4 të KPK, ka vendosur që të akuzuarit A. V koha e kaluar në paraburgim prej datës .....e deri më datën....., t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet më 1 (një) ditë e dënimit me burgim.*

## **12. Dënimi plotësues**

*Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 54 dhe 60 të KPK, si dhe në bazë të nenit 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të akuzuarit A. V, shqiptohet edhe dënimi plotësues - marrja, përkatësisht konfiskimi i armës së zjarrit e markës e "...", modeli....*

## **13. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike**

*Duke u bazuar në nenin 112 të KPPK, trupi gjykues ka vendosur që të dëmtuarit N...., Sh... dhe S. V, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohen në kontest civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë e as të pjesërishëm të këtyre kërkesave.*

## **14. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës**

*Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, duke u bazuar në nenin 102 të KPPK, trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari Adem Veseli të*

**detyrohet për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 150 € (njëqindpesëdhjetë Euro), në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në emër të kompensimit të shpenzimeve të ekspertit mjekoligjor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.**

**Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Krimeve të Rënda**

**Më 10 maj 2016**

**Sekretarja juridike,**

**Mejreme Tahiri**

**Kryetari i trupit gjykues,**

**Afrim Shala**

**KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.**